



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË
BORDI

VENDIM

Nr.131, Datë 29.08.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELECTRAL BATRA HPP”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGISJË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10 pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.08.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., si dhe relacionin Nr.79/10.prot.datë 27.08.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Konstatoi se:

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511 Prot., datë 13.08.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Neni 6, objekti i veprimtarisë së aplikuesit në aktivitetin e kërkuar për licencim- I pa plotësuar. Në objektin e veprimtarisë së aplikuesit, mungon aktiviteti i tregëtimit.
 - Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është i pa plotësuar.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, plotësuar.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor “d” “e”, janë plotësuar pjesërisht.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. është një subjekt tregtar i rregjistruar në QKB, në datën 23.12.2016, konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit”, që

mban NUIS L62423006M dhe statusin e *Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar* si dhe kapitali themeltar prej 1.000.000 lekësh referuar ekstraktit të QKB, zotërohet nga ortakun "ALBAVIA" sh.p.k me 10 % të kuotave dhe ortakun "ELEKTRAL" sh.p.k me 90 % të kuotave.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: *"Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e HEC-eve Batra nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 dhe transferimi i tyre në përfundim të Kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.*

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 6, objekti i veprimtarisë së aplikuesit në aktivitetin e kërkuar për licencim;
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat "a", "b", "c");
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2 gërma "d" (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria);
- Neni 9, pika 2 gërma "e" (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca);
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) gërma "c" (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8, gërmat "a"/"d" (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh / sipas viteve);
- Neni 9, pika 4.8, gërma "b" (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); Do të kërkohet shoqërisë "ELECTRAL BATRA HPP" sh.p.k. të paraqesë në ERE kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie të shoqëruar me dokumentacion mbështetës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "ELECTRAL BATRA HPP" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit AHMETI